

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat Administrative të Tregut të Punës, Korrik 2023

31.08.2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat Administrative të Tregut të Punës për muajin qershor 2023.

Numri i të punësuarve me pagë primare dhe sekondare shënoi rritje në korrik 2023, krahasuar me korrik 2022

Të punësuarit me pagë primare

Në muajin korrik 2023, të punësuar me pagë primare ishin 367 780 persona, ku krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (Korrik 2022, që ishin 359 487), ka rritje për 8 293 persona ose 2.3% të punësuar me pagë primare. Grup-mosha me më së shumti të punësuar me pagë primare ishte 25-34.

Punësimi sipas grup-moshës	Gjithsej me pagë primare	
	Korrik 2022	Korrik 2023
15-24	50 192	60 884
25-34	97 296	95 869
35-44	82 423	83 172
45-54	63 306	64 838
55-64	45 769	45 975
65+	12 726	12 579
Nuk ka informata	7 775	4 463
Gjithsej	359 487	367 780

Të punësuarit me pagë sekondare

Në muajin korrik 2023, të punësuar me pagë sekondare ishin 18 324 persona, ku krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak (Korrik 2022), ka rritje për 2 187 persona ose 13.6% të të punësuarve me pagë sekondare. Grup-mosha me më së shumti të punësuar me pagë sekondare ishte 35-44.

Punësimi sipas grup-moshës	Gjithsej me pagë sekondare	
	Korrik 2022	Korrik 2023
15-24	984	1 301
25-34	3 859	4 257
35-44	4 800	5 384
45-54	2 861	3 231
55-64	1 912	2 102
65+	955	1 511
Nuk ka informata	766	538
Gjithsej	16 137	18 324

Punësimi sipas aktiviteteve

Punësimi më i theksuar për muajin korrik ka qenë në këto aktivitete: administrata publike dhe mbrojtje, sigurim i detyrueshëm social (22,3%), tregti me shumicë dhe pakicë (22,1%), dhe prodhim (11,2 %).

Punësimi sipas aktiviteteve dhe gjinisë (%), moshë 15 e më shumë për muajin qershor 2023

Kosovë (mosha 15 e më shumë)		Korrik 2023			
		Meshkuj	Femra	Nuk ka informata	Gjithsej
Punësimi sipas aktiviteteve		%			
A	Bujqësi, pylltari dhe peshkim	0,9	0,9	0,6	0,9
B	Minierat dhe xehroret	1,8	0,3	0,8	1,2
C	Prodhimi	12,6	8,9	11,8	11,2
D	Furnizimi me elektricitet, gaz, avull dhe klimatizim	2,7	0,6	1,7	1,9
E	Furnizimi me ujë, ujërat e zeza, menaxhim i mbetjeve	2,1	0,6	0,2	1,5
F	Ndërtimtari	8,6	2,5	9,2	6,3
G	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime automjetesh dhe motoçikletash	20,4	24,9	19,7	22,1
I	Aktivitet akomodimi dhe shërbimesh ushqimi	6,3	4,6	8,8	5,7
H	Transport dhe depozitim	3,0	1,2	1,9	2,3
J	Informim dhe komunikim	4,3	4,0	6,7	4,2
K	Aktivitetet financiare dhe sigurimesh	5,5	4,9	2,5	5,2
L	Aktivitetet me prona të paluajtshme	0,3	0,3	0,4	0,3
M	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	3,0	3,6	6,2	3,2
N	Aktivitetet administrative dhe shërbime mbështetëse	2,9	4,1	4,3	3,4
O	Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social	20,2	26,1	8,2	22,3
P	Arsimi	0,8	2,7	4,2	1,6
Q	Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe punës sociale	0,9	3,5	3,4	1,9
R	Arti, zbavitja dhe rekreacioni	0,6	0,5	1,5	0,6
S	Aktivitetet të shërbimeve të tjera	2,1	4,2	6,0	2,9
T	Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; aktivitete prodhuese të mallrave dhe shërbimeve të padiferencuara të ekonomive familjare për përdorim vetanë	0,0	0,1	0,0	0,0
U	Aktivitetet të institucioneve dhe organizatave jashtë-territoriale	0,4	0,5	0,5	0,5
MN	Mungon aktiviteti	0,6	1,1	1,4	0,8
Gjithsej		100,0	100,0	100,0	100,0

Këto të dhëna bazohen në të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK).

Ky publikim ofron të dhëna për numrin e të punësuarve të kategorizuar sipas: gjinisë, grup-moshës, numrit të të punësuarve me pagë primare dhe sekondare, përqindjes së të punësuarve sipas aktiviteteve ekonomike, si dhe të dhënat për punëkërkesit e regjistruar sipas gjinisë dhe grup-moshës.

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Statistikave Administrative të Tregut të Punës për muajin korrik 2023, vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/LaborMarket>